

RENDI SHTËPIAK I SHKOLLËS FILLORE KOMUNALE „BRATSTVO-MIGJENI,, TETOVË

- ❖ Me rendin shtëpiak të Shkollës rregullohet rendi, disciplina, raporti mes nxënësve, arsimtarëve dhe mësimit në Shkollë; Sipas Ligjit për arsim fillor, si dhe Statusit të Shkollës, nxënësit kanë të drejta të cilat i realizojnë nëpërmjet mësimit dhe formave tjera të punës edukativo-arsimore, por njëkohësisht kanë edhe obligime të cilat duhet ti respektojnë dhe plotësojnë.
- ❖ Në shkollë mësimi rrjedh në dy ndryshime në të katër objektet. Ndryshimi i parë fillon në ora 7³⁰ minuta kurse i dyti në ora 13³⁰ minuta;
- ❖ Hyrja zyrtare shërben vetëm për hyrjen e arsimtarëve, nxënësve dhe palëve;
- ❖ Derën kryesore të oborit të shkollës e shfrytëzojnë nxënësit;
- ❖ Zyrën e arsimtarëve e shfrytëzojnë vetëm arsimtarët, e jo edhe prindërit dhe nxënësit;
- ❖ Në secilën paralele në vend publik ka të ngjitur kodeks për sjelljen e nxënësve;
- ❖ Në vend publik është ngjitur orari i mësimit në të katër objektet e shkollës;
- ❖ Përgjegjës për inventarin e shkollës janë nxënësit kujdestar, bashkësitë e klasave dhe arsimtarët lëndor dhe klasor;
- ❖ Lëviz nëpër koridor pa vrap, kërcim dhe shtyrje;
- ❖ Nxënësit duhet që hijerat personale të tyre ti lënë në klasë ose ti marrin me vete dhe ata janë përgjegjës për të njëjtat;
- ❖ Për çdo dëm të bërë me qëllim ndërmiret masë pedagogjike;
- ❖ Ndalohet reptësisht gërvishtaja e mureve, në cilën do pjesë të shkollës;
- ❖ Është e ndaluar reptësisht dhuna e cilës do forme;
- ❖ Asnjëri nga subjektet e shkollës nuk guxon të shkatërojë pronën në shkollë, të fus persona nga jashtë pa arsye dhe të fus substanca (drogë, alkoohol, lëndë djegëse dhe mjete tjera) me të cilat do të kërcënojnë shëndetin dhe sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve;
- ❖ Ndalohet pirja e duhanit në shkollë dhe obor të shkollës;
- ❖ Arsimtarët kujdestar e mbajnë kujdestarinë në koridoret e shkollës sipas orarit të caktuar nga drejtori;
- ❖ Gjatë kohës së orëve të mësimit në koridore kujdestarojnë arsimtarët;
- ❖ Për zëvendësim të orëve arsimtari duhet të lajmërojë në kohë drejtorin;
- ❖ Çdo i punësuar për mungesën e tij duhet patjetër të lajmërojë drejtorin;
- ❖ Prindërit do të pranohen vetëm në orare të caktuara tek arsimtarët lëndor dhe klasor, kurse të shërbimi profesional sipas kushteve dhe nevojave, ndërsa çdo arsimtar ka të përcaktuar ditën për bashkëpunim me prindërit të ngjitur në vend publik;
- ❖ Nuk lejohet që arsimtarët pa nevojë të dalin nga ora për të biseduar me prindër, kjo mund të arsyetohet vetëm në raste urgjente dhe të përdorin celular në orë;
- ❖ Arsimtarët duhet ti lajmërojnë nxënësit për oraret e mbajtjes së orëve shtuese dhe plotësuese dhe aktivitetet e lira të nxënësve;
- ❖ Të punësuarit, nxënësit dhe prindërit duhet që në shkollë të vijnë të veshur në mënyrë të duhur;
- ❖ Ndalohet mbajtja e shenjave fetare dhe partiake në shkollë.

DREJTORI – RIZA ETEMI